



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË

Viti mësimor 2015-2016

Faza e dytë

Klasa 10

Skema e vlerësimit të testit

- 1.
- a)
- Papa si autoriteti më i lartë i kishës, kishte të drejtën të kurorëzonte perandorët, duke treguar epërsinë e pushtetit fetar. **1 pikë**
 - Në favor të kishës paguhej taksë e veçantë si në para, ashtu edhe në natyrë e njohur si “e dhjeta e kishës”. **1 pikë**
 - U krijua një shtresë e fuqishme e feudalëve kishtarë, të quajtur “princa të kishës”. **1 pikë**
 - Kisha mori në zotërim prona të pafundme. **1 pikë**
- b) **2 pikë**
- Figura morale e kompromentuar e një pjese të klerikëve.
 - Humbje e vlerave të hershme të krijimit të saj.
 - Devijim i rolit të kishës në lidhje me nevojat shpirtërore dhe problemet e popullit.
 - Krijimi i strukturës së Inkuizionit të Shenjtë dhe qëndrimi persekutor i saj tronditi besimin e njerëzve të thjeshtë.
 - Imazhi i kishës u çënuar edhe nga të ashtuquajtura “letra falje” ose indulgjenca.
- Nxënësi fiton:**
- 2 pikë** nëse shkruan dy nga të mësipërmet
- 1 pikë** nëse shkruan një nga të mësipërmet
- c)
- Forcimi i monarkive kombëtare pikërisht në këtë periudhë. **1 pikë**
 - Degëzimi i krishtëritimit në ortodoksizëm dhe katolicizëm në vitin 1054. **1 pikë**
 - Deshtimi i fushatave fetaro-ushtarake (kryqëzatave) që u organizuan posaçërisht për rritjen e autoritetit të kishës, por që në fakt patën efektin e kundërt duke e minuar këtë autoritet. **1 pikë**
 - Presioni që vinte nga Lindja ku përhapja e besimit islam, ngushtonte gjithnjë e më shumë hapësirat e krishtëritimit. **1 pikë**
- 2.
- a) Studimet e fundit kanë zbuluar se termi pellazg është përdorur për të emërtuar më shumë se një popullsi në territorin e Ballkanit **1 pikë**
- b) Dodona është një qytezë në zonën e Janinës, Greqia e sotme. **1 pikë**
- c) Shqiptarët e praktikojnë flijimin e kafshëve si rit fetar mysliman, bektashi por edhe si rit fetar pagan, në rastin kur bëjnë fli një kafshë në themelet e shtëpisë që do të ndërtojnë. **1 pikë**
- d) Albanologët shqiptarë e të huaj pretendojnë se: **3 pikë**

- Ka ngjashmëri në ato pak fjalë që janë gjetur mes pellazgëve;
- Përkon territori i banuar prej pellazgëve me atë të ilirëve e më pas të arbërve-shqiptarëve.
- Popullata ilire trashëgoi shumë nga zakonet pagane të pellazgëve, siç është varrimi me tuma dhe jo me urna.

3.

a)

- Në Kretë ishte shumë e zhvilluar poçaria. Stili i përdorur kishte për bazë figurat gjeometrike këndore, ndërsa në Mikenë ato të lakuara. **1 pikë**
- Në Kretë u përdorën dy lloj shkrimesh: linear A dhe linear B, ndërsa në Mikenë nuk ka patur arritje të tilla. **1 pikë**
- Në Mikenë ishte karakteristikë ndërtimi i oborreve (megaronë) dhe ndërtimi i qyteteve të fortifikuara. **1 pikë**
- Në Kretë i ka fillesat qeverisja teokratike **1 pikë**

b)

- Përdorimi i alfabeti grek; **1 pikë**
- Mënyra e organizimit të shtetit; **1 pikë**
- Arti etrusk huazoi elemente nga artin grek. **1 pikë**

4.

a) **3 pikë**

- Të drejtën e votimit për organet qeverisëse e kishin të gjithë njerëzit, pavarësisht statusit social
- Përfaqësimi i popullit në Asamblenë e Përgjithshme;
- Prona private si e drejtë ligjore e trashëgueshme;
- Kundërshtimi i popullit për ligje të veçanta, për të cilat ata mendonin se nuk ishin në shërbim të tyre.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse shkruan tre nga të mësipërmet

2 pikë nëse shkruan dy nga të mësipërmet

1 pikë nëse shkruan një nga të mësipërmet

b)

- Ndarja e popullsisë bazuar mbi pasurinë, duke krijuar privilegj për shtresat e pasura; **1 pikë**
- Qeveritarët zgjidheshin nga shtresat e pasura; **1 pikë**
- Organi gjyqësor nuk ishte i pavarur, por në varësi herë të përfaqësuesve të Asamblesë, e herë të Këshillit të 500-ve. **1 pikë**

5.

- Si në Spartë ashtu edhe në Perandorinë Osmane në fillimet e veta, shteti kishte më shumë funksione ushtarake sesa civile; **1 pikë**
- Në Spartë, mbretërit ndihmohej në marrjen e vendimeve nga këshilli i aristokratëve. Po kështu në Perandorinë Osmane, sulltani, ndihmohej në marrjen e vendimeve nga Divani, këshilli perandorak; (pavarësisht kompetencave që kishte secili nga organet: këshilli i aristokratëve dhe Divani). **1 pikë**

- Si në Spartë ashtu edhe në Perandorinë Osmane i kushtohej një rëndësi të veçantë edukimit ushtarak. Në Spartë perioda e përgatitjes ushtarake fillonte nga mosha 7 dhe përfundonte në 30 vjeç, ndërsa në Perandorinë Osmane nga 6 deri në 25 vjeç. **1 pikë**
- Si në Spartë ashtu dhe në Perandorinë Osmane, në fillimet e hershme të saj, toka ishte pronë e shtetit. **1 pikë**

6.

- a) **5 pikë**
- Vendosnin çmimet dhe tregjet e shitjes
 - Sasinë e prodhimit
 - Hierarkinë e profesionit (çirakë, kallf, mjeshtër)
 - Pagën e punonjësve
 - Blerjen e lëndës së parë
 - Kohën e punës
 - Kishin monopolin e tregut

Nxënësi fiton:

5 pikë nëse shkruan pesë nga të mësipërmet

4 pikë nëse shkruan katër nga të mësipërmet

3 pikë nëse shkruan tre nga të mësipërmet

2 pikë nëse shkruan dy nga të mësipërmet

1 pikë nëse shkruan një nga të mësipërmet

- b) Qytetet komuna ngjanin me qytet-shtetet greke. **1 pikë**

7.

- a)
- Monarki **1 pikë**
 - Republika **1 pikë**
 - Perandori **1 pikë**

- b)
- fillimisht qeverisja realizohej nëpërmjet dy konsujve (pretorë/magjistrat). **1 pikë**
 - Diktator – përqendrimi i pushtetit në një dore te vetme ne periudhe trazirash për vetëm 6-muaj. **1 pikë**
 - 2 periudhat e Triumviratit – ndarja e pushtetit ne tre figura qe erdhi si pasoje e periudhës se diktaturës. **1 pikë**

- c)
- Triumvirati **1 pikë**
- pjesëmarrja dhe kontributi në shtypjen e kryengritjes së skllëvërve të Spartakut. **1 pikë**
 - Çlirimi i Romës nga kërcënimi i piraterisë. **1 pikë**
 - Përballja me Mitridatin, mbretin e Pontit që përbënte një rrezik serioz për Romën. **1 pikë**